



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2633/Prot.
3

Tiranë, 26.6 2019

VENDIM

Nr. 24, datë 26.06 2019

“Për një ndryshim në emërtesën e vendit të punës nga “Bibliotekar/e” në emërtesën “Klasifikator/e” në Bibliotekën e Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës”

Bazuar në nenin 38, pika 1/ç, të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”; me propozim të Fakultetit të Shkencave Sociale (shkresat nr.1330/4 datë 20.03.2019 dhe nr.1330/5 datë 06.06.2019) dhe sipas korrespondencës shkresore me Administratorin e UT në lidhje me këtë çështje, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e tij të datës 26.06.2019,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e emërtesës së vendit të punës nga “Bibliotekar/e” në emërtesën “Klasifikator/e” në strukturën organizative të Bibliotekës të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, të miratuar me Vendimin e Senatit Akademik të UT nr. 8, datë 26.03.2018, pika 2.
2. Ky Vendim i përcillet Bordit të Administrimit të UT, për miratimin e ndryshimeve në fondet buxhetore të Fakultetit të Shkencave Sociale, në lidhje me efektet financiare që rrjedhin nga ky ndryshim.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
PROF. DR. MYNYR KONI

